



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1017/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Oxygen Pharma” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810032920, me seli në Prishtinë, me adresë Çagllavicë, Dardanët nr.30, kundër debitorit “PharmaTree Distribution” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 811869471, me seli në Prishtinë, rr. “Nënë Tereza”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.227/22 të datës 21.04.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 20.12.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i paraqitur nga debitori ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr. 227/22 i datës 21.04.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Oxygen Pharma” Sh.P.K., ka lëshuar Urdhrin përmbarimor P.nr.227/22 i datës 21.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit faturë nr.655/22 e datës 14.01.2022 ashtu që është urdhëruar debitori “PharmaTree Distribution” Sh.P.K., që në emër të borxhit që rrjedh nga fatura e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 1,525.39 EUR, (me shkronja: njëmijë e pesëqind e njëzetë e pesë euro e tridhjetë e nëntë cent) me kamatë ligjore prej 8% sipas LMD-së si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor me arsyetimin se përmbaruesi privat nuk ka vepruar drejtë dhe ka shkelur dispozitat procedurale të LPP-së, për faktin se bazuar në dispozitat e nenit 37 të LPP-së përmbaruesi privat nuk ia ka bashkangjitur

propozimit për përmbarim faturat të cilat paraqesin dokument të besueshëm. Pra, në rastin konkret debitorit i është dorëzuar vetëm propozimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim, por jo edhe faturat në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbarimore. Tutje ka shtuar se faturat e përshkruara në propozim debitori nuk i disponon dhe të njejtat nuk i ka pranuar asnjëherë meqenëse nuk janë as të vulosura e as të nënshkruara nga ana e tij. Andaj ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizojë Urdhrin për Përmbarim P.nr. 414/2022 të datës 21.04.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me faktin se fatura e cila është objekt i këtij përmbarimi është dokument i cili është dërguar me të gjitha produktet dhe specifikat e tyre tek subjekti PharmaTree Distribution sh.p.k me ç'rast personi përgjegjës e ka bërë pranimin e produkteve dhe e ka nënshkruar dokumentin, dhe se me këto pretendime debitori vetëm synon që ta shtyj sa më shumë në kohë obligimin e tij të cilat rrjedhin sipas faturës nr.655/2022 e cila është pranuar nga debitori me datë 14.01.2022. Po ashtu në faturën me nr.655/2022 e pranuar nga debitori me datë 14.01.2022, në pjesën e vërejtjeve, para pjesës ku është e nënshkruar edhe nga vet debitori është e shkruar tekstualisht se pagesa bëhet sipas marrëveshjes me blerësin në tre (3) pjesë. Andaj ka kërkuar nga Gjykata që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të lihet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.227/22 datë 21.04.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në*

bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se fatura nr.655/22 e datës 14.01.2022 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar me rregull nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e vënë tek pranuesi i faturës, dhe e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë është e përshatshme për përmbarim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se në rastin konkret fatura është e papërshatshme për përmbarim pasi që e njëjta nuk është pranuar nga debitori, por që nga dëftesa e pagesës e datës 16.06.2022 e cila është bashkëngjitur nga kreditori në përgjigje ndaj prapësimit, rezulton se debitori ka paguar pjesërisht faturën nr. 655/22 në vlerë prej 700.00 EUR, andaj i njëjti ka qenë i njoftuar me faturën e lartcekur dhe detyrimin që buron nga kjo faturë. Ndërsa, pretendimi i debitorit se me kreditorin kanë pasur marrëveshje që pagesa të bëhet me kompensim dhe se debitori ka kërkuar kthimin e mallit rezulton të jetë i paqëndrueshëm, kjo për faktin se në faturën objekt i këtij përmbarimi, afati për reklamacion të mallit të dorëzuar ka qenë në afat prej njëzet e katër (24) orësh, që paraqet edhe afatin e pagesës së kësaj fature, ndërsa debitori, nuk ka paraqitur kundërshtim brenda këtij afati në raport me përmbajtjen e faturës dhe mallit të dorëzuar nga kreditori.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1017/23, datë 20.12.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.